

Rreth kësaj çështjeje dijetarët ndajnë dy mendime:

Mendimi i parë: Preferohet dhënia e zekatul fitrit për fëmijën në barkun e nënës, por nuk detyrohet. Ky është mendimi i dijetarëve të katër medhhebeve.[\[1\]](#)

Argumentet e këtij mendimi:

1. Përcillet se Othmani, *radijallahu anhu*, e jepte zekatul fitrin për të voglin, për të madhin dhe për foshnjën.[\[2\]](#) Ndërkaq, Ebu Kilabete, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Njerëzit e jepnin zekatul fitrin, madje e jepnin edhe për foshnjën.”[\[3\]](#) Gjithashtu, tregohet se Sulejman ibn Jesari, *Allahu e mëshiroftë!*, është pyetur se a duhet dhënë zekatul fitri për foshnjën, me ç’rast ka thënë po.[\[4\]](#)

Nga këto transmetime, dijetarët që mbajnë këtë mendim, kanë kuptuar se një gjë e tillë është e preferuar.[\[5\]](#)

2. Meqë kafsha në barkun e nënës së saj nuk bën pjesë në mesin e atyre për të cilat duhet dhënë zekati, atëherë as fëmija në barkun e nënës nuk hyn në mesin e atyre për të cilët duhet dhënë zekatul fitri.[\[6\]](#)
3. Rregullat dhe dispozitat e kësaj bote (të të gjallëve) nuk zbatohen kundrejt fëmijës në barkun e nënës, përveç trashëgimisë dhe testamentit, madje me kusht që të dalë i gjallë nga barku i nënës së vet.[\[7\]](#)

Mendimi i dytë: Dhënia e zekatul fitrit për fëmijën në barkun e nënës është e detyruar. Ky është një prej transmetimeve të imam Ahmedit,[\[8\]](#) kurse disa të mëhershëm dhe Ibn Hazmi detyrimin e saj e kanë kushtëzuar që fëmija në barkun e nënës duhet t’i mbushë njëqind e njëzet ditë para se të arrijë agimi i ditës së Bajramit,[\[9\]](#) sepse kjo është koha kur embrionit i jepet shpirti. Këtë e vërteton hadithi i Ibn Mesudit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, që thotë: “Na ka treguar i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue sel-lem*, që njëherazi është më besniku: “Çdo njeri formohet në mitrën e nënës së vet duke qëndruar dyzet ditë si pikë e lëngshme (nutfeh), pastaj, për po aq ditë, bëhet droçkë gjaku (alekah), më pas, për dyzet të tjera, bëhet copë mishi. Pas kësaj i dërgohet një engjëll, që e frymëzon me shpirt duke u urdhëruar me katër gjëra: (1) me shkrimin e rriskut (furnizimit), (2) kohëzgjatjen e jetës, (3) veprat e tij dhe (4) a do të jetë i lumtur apo i dëshpëruar...”[\[10\]](#)

Përgjigjja ndaj argumentimit me këtë hadith: Jeta e fëmijës nuk dihet sigurt dhe askush, përveç Allahut, nuk e di se ç’ka në mitër. Ka mundësi të supozohet shtatzënia e të mos ekzistojë fare.[\[11\]](#) Prandaj, fëmija nuk posedon asgjë pa dalë në këtë botë.[\[12\]](#)

Argumentet e këtij mendimi:

1. Transmetimet nga Othmani, *radijallahu anhu*, nga Ebu Kilabete dhe Sulejman ibn Jesari, *Allahu e mëshiroftë!*, me të cilat argumentojnë edhe dijetarët e mendimit të parë. Nga këto transmetime këta dijetarë kuptuan obligueshmërinë e zekatul fitrit për fëmijën, duke ditur se Othmanin,

radijallahu anhu, në lidhje me këtë nuk e kishte kundërshtuar asnjë sahab.[\[13\]](#)

Përgjigjja ndaj këtij argumenti:

Së pari: Zinxhiri i transmetimit të Othmanit, *radijallahu anhu*, është i dobët.

Së dyti: Ebu Kilabete, *Allahu e mëshiroftë!*, nuk përmend kush janë ata që e jepnin zekatin për foshnjën, madje, edhe po të përmendte ndonjë sahab, nuk do të ishte argument i mjaftueshëm për obligueshmëri.

Së treti: Po ashtu, transmetimi i Sulejman ibn Jesarit, *Allahu e mëshiroftë!*, nuk është i saktë.[\[14\]](#)

Së katërti: Edhe sikur këto transmetime të ishin të sakta, mund të thuhet se ajo që nënkuptohet prej tyre është se dhënia e zekatul fitrit për embrionin është e preferuar, jo e detyruar.

2. Hadithi që e përcjell Abullah ibn Omeri, *radijallahu anhu*, tek thotë: "*Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, e ka detyruar dhënien e zekatul fitrit, një saë*[\[15\]](#) *elbi apo një saë hurmash për çdo person, të madh apo të vogël, të lirë apo rob.*"[\[16\]](#) Ky hadith përfshin edhe embrionin sepse edhe ai quhet "i vogël."[\[17\]](#)

Përgjigjja ndaj këtij argumentimi: Hadithi i përfshin vetëm të gjallët e kësaj bote, kurse embrioni nuk përfshihet sepse atij nuk i thuhet "i vogël", as në kontekstin gjuhësor, as në atë zakonor.[\[18\]](#)

3. Foshnja është krijesë njerëzore, lejohet që të lihet testament në emër të saj dhe trashëgon, andaj edhe atë e përfshijnë citatat që flasin rreth kësaj teme. Rrjedhimisht, sa u përket dispozitave të zekatul fitrit, fëmija në barkun e nënës krahasohet me fëmijën që ka lindur dhe jeton në këtë botë.[\[19\]](#)

Mendimi më i saktë

Mendimi më i saktë rreth kësaj dispozite është mendimi i parë, arsyetuar me sa vijon:

1. Në parim, asnjë çështje nuk gjykohet si detyrim pa argument të qëndrueshëm, gjë që këtu nuk ekziston.
2. Sipas disa dijetarëve ky është mendimi i dijetarëve të katër medhhebeve.
3. Dhënia e zekatul fitrit për foshnjën nga ana e disa të parëve tanë, siç u pa në transmetimet e mësipërme, e të cilat pothuajse të gjithë dijetarët e fikhut i përmendin në librat e tyre.
4. Krahasimi i kësaj me sadakatë (lëmoshat) e tjera vullnetare.[\[20\]](#)
5. Ajo që jepet për zekatul fitër nuk është pasuri e madhe, prandaj, dhënësi i saj shpërblehet për

këtë, njëkohësisht nuk dëmtohet materialisht.

Allahu e di më së miri.

Arben Ahmetaj

[1]. Sqarime:

Dijetarët e katër medhhebeve kanë rënë në ujdi për mosobligueshmërinë e dhënies së zekatul fitrit për fëmijën në barkun e nënës, kurse Ibnul Mundhiri, në librin e tij *El Ishraf ala medhahibil ulema* (3/72), përmend konsensusin e dijetarëve për këtë çështje. Shih *Tuhfetul fukaha* (1/336), *El Xheheretu nejiretu ala Muhtesar el Kudurij* (1/133), *Et Tefriu fi fikhil imami Malik ibn Enes* (1/164), *Edh Dhehiretu* (3/157), *Bahrul medhheb* (3/210), *Reudatu talibine* (2/295), *El Mesailul fikhijetu min kitabi Rriuaajetejni uel uexhhejni* (1/246), *El Mugni* (3/99).

Dijetarët e medhhebit hanbeli në librat e tyre kanë cekur se preferohet dhënia e zekatul fitrit për embrionin. Disa prej tyre kanë thënë se edhe medhhebet e tjera e kanë këtë mendim. Shih *El Furu*, i Ibnul Muflihut (4/221), *Hashijetu rreud el murbi*, i Ibnul Kasimit (3/277), ndonëse gjatë hulumtimit në këtë temë nuk kam hasur citate të dijetarëve të medhhebeve në fjalë që do ta vërtetojnë një gjë të tillë. Gjithashtu, Ibnul Mundhiri, në librin e tij *El Ixmau* (f. 47), ka thënë se imam Ahmedi e parapëlqente dhënien e zekatul fitrit për foshnjën, gjë që tregon se të tjerët nuk e preferonin. Prandaj, nëse nuk konfirmohet se një gjë e tillë është e preferuar te të gjitha medhhebet, them se ajo është e lejuar te të gjithë, kurse e preferuar te dijetarët hanbeli.

[2]. *Musanef Ibn Ebi Shejbe* (2/432), 10737; *Mesailul imam Ahmed*, transmetimi idjalit të tij, Abdullahut (1/170), 644; *El Muhala* (4/253-254).

[3]. *Musanef Ibn Ebi Shejbe* (2/397), 10362; *El Muhala* (4/254).

[4]. *Musanef Abdirrezak* (3/319), 5790; *El Muhala* (4/254).

[5]. Shih *El Mugni* (3/99).

[6]. Shih referencën paraprake.

[7]. Shih referencën paraprake, *Sherhu Zerkeshij ala Muhtesar el hirekij* (2/547).

[8]. Shih *El Hidajetu ala medhhebil imam Ahmed* (f. 142), *El Insafu fi marifeti rraxhihi minel hilaf* (3/168), ku autori thotë: "Ibn Nasrullahu... ka thënë: "Mund të thuhet se është e detyruar dhënia e zekatul fitrit për embrionin që i ka mbushur katër muaj, kurse para kësaj periudhe është e pëlqyer."

[9]. Shih *El Muhala* (4/253), *El Ilam bi fevaiddi Umdet el ahkam* (5/129), *Tarhu Tethribi* (4/60), *Fet'hul Bari* (3/369), *Umdetu el Karii* (9/110).

[10]. *Sahihul Buhari* (4/111), 3208; *Sahihu Muslim* (4/2036), 2643.

[11]. Shënim: Këta dijetarë bëjnë fjalë për kohën e tyre, kur nuk kishte mjete dhe vegla precize për të ditur shtatzëninë.

[12]. Shih *Tuhfetul fukahai* (1/336), *Tarhu Tethribi* (4/60).

[13]. Shih *El Muhala* (4/253-254), *Sherhu Zerkeshij* (2/547).

[14]. Shih *Tarhu Tethrib* (4/60).

[15]. Njësi peshe.

[16]. *Sahihul Buhari* (2/132), 1512; *Sahihu Muslim* (2/677), 984.

[17]. Shih *El Muhala* (4/253).

[18]. Shih *Tarhu Tethrib* (4/60), *Fet'hul Bari* (3/369).

[19]. Shih *El Mugni* (3/99), *Sherhu Zerkeshij* (2/547).

[20]. Shih *El Mugni* (3/99).